



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1093 Prot

Durrës, më: 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 63, datë 30.04 2026

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "SUSTAINBLE TOURISM", PRANË FAKULTETIT TË BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS ME UNIVERSITETIN E TERAMO-S, ITALI"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "*Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar*"; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"*"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë"*", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"*"; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; bazuar në propozimin e Njesisë Kryesore FB, si dhe në relacionin nr. 839/5 prot., datë 30.04.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Sustainable Tourism", në Departamentin e Turizmit, pranë Fakultetit të Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës me Universitetin e Teramo-s, Itali, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhët **Shqip/Anglisht/ Italisht**.
3. Kodi i programit të studimit: **63BA1015S**.

4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në Ministrinë e Arsimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

